

23.03.2021

Ora 14:20

Seancë publike e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për caktimin e kohës së transmetimit në radiotelevizionin publik, të fushatës zgjedhore të partive të regjistruara si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ:

Y.Merkaj, M.Koja, E. Allushi,

V. Ballgjini

• **Parti Politike:**

LSI, PSD, LN, PDIU

• **Koalicione:**

ABEOK, ADR

Z. I. Celibashi: Mirëdita të gjithëve! Atëherë në rendin e ditës të seancës publike të sotme janë këto çështje:

1. Projektvendimi “Për caktimin e kohës së transmetimit në radioTelevizionin Publik të fushatës zgjedhore të partive të regjistruara si subjekte zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021”.


2. Projektvendimi “Për miratimin e sasisë së vulave rezervë të komisionit të qendrës së votimit që do të prodhohen për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

3. Projektvendimi “Për caktimin e sasisë së fondit publik që do të shpërndahet paradhënie partive të regjistruara si subjekte zgjedhore për këto zgjedhje”.

4. Projekt udhëzimi “Për përdorimin e materialeve propagandistike, edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

Zbardhi materialin audio

Jonida SALILLARI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

5. Projektvendimi “Për një shtesë në vendimin nr. 151 datë 16.03.2021 “Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të Misionit të ODIHR, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021”
 6. Projektvendimi “Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të Fondacionit Shqiptar për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara për vëzhgimin e zgjedhjeve të datës 25 Prill 2021”.
 7. Projektvendimi “Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të Community Reporters për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021”.
 8. Projektvendimi “Për miratimin e gazetarëve të Televizionit A2Cnn për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021”.
 9. Projektvendimi “Për miratimin e gazetarëve të Televizionit Klan News, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021”.
 10. Projektvendimi “Për miratimin e gazetarëve dhe operatorëve të Televizionit Ora News, për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 prill 2021”.
- Mirë, atëherë fillojmë me pikën e pare të rendit të ditës.


Z. Y. Merkaj: Zoti Komisioner përpara se të kalojmë tek rendi i ditës doja të bëja një kërkesë për shtesë të një pike meqenëse ka të bëjë me lirim dhe emërim të anëtarëve të KZAZ-ve. Në KQZ na ka ardhur në minutat e fundit dhe ta shtojmë në rendin e ditës si pika 11.

Z. I. Celibashi: Mirë, dakord e shtojmë si pikë në rendin e ditës projektvendimin që ka të bëjë me lirim nga detyra të disa anëtarëve të KZAZ-së dhe emërimin e anëtarëve zëvendësues në këtë detyrë. Po, vazhdojmë.

Z. Y. Merkaj: Atëherë, neni 19 paragrafi 1 shkronja “ë” e Kodit Zgjedhor parashikon kompetencë të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për monitorimin

Zbardhi materialin audio


Joni SAHLLARI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

nëpërmjet administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve apo subjekteve të kontaktuara të fushatës zgjedhore. Ndër të tjera edhe procedimin e fushatës në media. Neni 80 pika 1 e Kodit Zgjedhor përcakton se radiotelevizioni publik vë minutash falas në dispozicion të partive politike të regjistruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve si subjekte zgjedhore për të bërë fushatën zgjedhore për zgjedhjet për Kuvend. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 80 shkronja "b" dhe "c" të Kodit Zgjedhor cakton minutash për partitë parlamentare sipas numrit të vendeve në Kuvend dhe ato që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit si dhe për partitë jo parlamentare. Partive parlamentare të cilat në zgjedhjet e fundit në kuvend kanë marrë më shumë se 20% të votave në Kuvend, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i cakton minutash të barabarte jo më ka se 30 minuta në Televizionin Publik dhe në radiot publike. Për partitë jo parlamentare kjo kohë është jo më pak se 15 minuta në Televizionin Publik dhe jo më pak se 15 minuta në radiot publike. Për partitë jo parlamentare që marrin pjesë në zgjedhje fitojnë 10 minuta në Televizionin Publik dhe 10 minuta në radiot publike. Me vendimin nr.555 të vitit 2017, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të viti 2017 duke përcaktuar numrin e mandateve të fituara nga çdo subjekt zgjedhor. Duke u bazuar në numrin e mandateve e fituara për zgjedhjet e fundit për Kuvend rezulton se partitë parlamentare të cilat në zgjedhjet e fundit për Kuvend kanë marrë më shumë se 20% të vendeve në Kuvend dhe janë regjistruar si subjekte zgjedhore të zgjedhjeve për Kuvend janë Partia Socialiste e Shqipërisë dhe Partia Demokratike. Partitë e tjera parlamentare të cilat në zgjedhjet e fundit për Kuvend kanë marrë më pak se 20% të vendeve në Kuvend dhe janë regjistruar si subjekte zgjedhore janë Lëvizja Socialiste për Integrim, Partia Drejtësi Integrim dhe Unitet, Partia Social Demokrate, Partia Fryma e Re Demokratike, Partia Republikane dhe Partia Kristian Demokrate. Duke analizuar nenin 80 pika 1 shkronja "b" të Kodit Zgjedhor minuta falas u

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

vihet në dispozicion i partive politike të regjistruara apo koalicioneve bazuar në parimin e performalitetit të numrit të konkurrentëve në garë. Konkurrenca politike në garë matet me numrin e subjekteve zgjedhore të cilat kanë dorëzuar listat shumemërore për kandidat për deputetë. Neni 65 pika 3 e Kodit Zgjedhor përcakton se të drejtat dhe detyrimet nga ky ligj caktohen për subjektet zgjedhore për mbushjen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Gjithashtu si subjektet zgjedhore pjesëmarrëse për zgjedhjet në Kuvend janë regjistruar dhe partitë politike parlamentare që konkurrojnë si parti më vete me 5 kandidatë të propozuar nga zgjedhësit, të cilët fitojnë 5 (pesë) minuta në televizion dhe 5 (pesë) minuta në radiot publike. Në përfundim të analizës se mësipërme i propozohet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve:

1. Caktimi i një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 90 (nëntëdhjetë) minutash, përkatësisht 60 (gjashtëdhjetë) minuta në Televizionin Publik dhe 30 minuta në Radion Publike për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të partive parlamentare, si më poshtë:

Koalicioni Aleanca.. Koalicioni Partia Demokratike Aleanca për Ndryshim dhe Partia Socialiste ju caktohet 90 (nëntëdhjetë) minuta.

2. Caktimi i një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 45 (dyzetë e pesë) minutash, përkatësisht 30 (tridhjetë) minuta në Televizionin Publik dhe 15 (pesëmbëdhjetë) minuta në Radion Publike për partitë, si më poshtë:


Partia Social Demokrate dhe Partia Lëvizja Socialiste për Integrim.

3. Caktimi i një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 20 (njëzetë) minutash, përkatësisht 10 (dhjetë) minuta në Televizionin Publik dhe 10 (dhjetë) minuta në Radion Publike për pasqyrimin e fushatës zgjedhore për partitë joparlamentare, si më poshtë:

a) Partia Lëvizja për Ndryshim,

b) Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare,

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

- c) Partia Bindja Demokratike,
- ç) Partia Balli Kombëtar,
- d) Partia Lëvizja e Re,
- dh) Partia Aleanca Demokracia e Re,
- e) Partia Nisma Thurje,
- ë) Koalicioni "ABEOK.

4. Caktimi i një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 10 (dhjetë) minutash, përkatësisht 5 (pesë) minuta në Televizionin Publik dhe 5 (pesë) minuta në Radion Publike për pasqyrimin e fushatës të kandidatëve të pavarur, si më poshtë:

- a) Elton Debreshi,
- b) Kreshnik Merxhani,
- c) Iljaz Shehu,
- ç) Bojken Abazi,
- d) Pal Shkambi.


Bashkangjitur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe dokumentacionin përkatës, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit! Përfaqësuese të partive politike fjala për ju.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e Partisë LN: Po. Përshendetje, faleminderit! Atëherë, unë mendova të nga 2, 3 sugjerime dhe një.. komente për këtë projektudhëzim, i cili në vetë vete dhe sipas relacionit është në përputhje me parashikimet ligjore. Ajo që unë konstatoj dhe vërej dhe pyes edhe kush e ka.. personat që e kanë relatuar është pse në këtë projektudhëzim është gjetur me vend të behët vetëm rregullimi për radiotelevizionin publik? Pra, thjesht janë reflektuar.. po themi kërkesat në nenin 80 të ligjit ndërkohë që Kodi Zgjedhor ka

Zbardhi materialin audio

Jonida SALILLARI




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

edhe fushatën zgjedhore në radiot dhe televizionet private. Sigurisht edhe ajo është e rregulluar mirë në nenin 84, por unë mendoj që ky udhëzim për të qenë më i plot duhet të parashikoj dhe pjesën që i takon radiotelevizioneve private dhe njëkohësisht mund të jetë faji im që nuk e gjejë. Por, doja të shtroja paraprakisht për një.. po themi transparencë të pasqyrimin të fushatës zgjedhore në media që flitet shumë që ka të bëjë dhe me financimin edhe vetë partive politike në pikën 5, fjalia e fundit e nenit 84 parashikohet që operatorët radiotelevizivë detyrohen të dorëzojnë 5 ditë përpara fillimit të fushatës tarifat për çdo segment kohorë pranë KQZ-së dhe këto tarifa publikohen në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Nëse llogarisim 25 Prill – 25 Mars, nëse unë gaboj ju kërkoj ndjesë, por ky afat ka kaluar dhe subjektet zgjedhore nuk janë të informuara se cilat janë këto tarifa të operatorëve radiotelevizivë privat. Faleminderit, kaq kisha pjesa tjetër pastaj mendoj që është në rregull.

Z. I. Celibashi: Po, faleminderit! Në lidhje me konsideratën e parë tuajën për sa i përket aktit që rregullon vetëm minutat e subjekteve zgjedhore pjesëmarrëse në këto zgjedhje në radiotelevizionin publik. Ky akt lidhet vetëm me këtë. Nëse e shikojmë të nevojshme që për radiotelevizionin privat ka nevojë për të rregulluar diçka më shumë se sa vetë Kodi Zgjedhor parashikon, ne mundet ta konsiderojmë. Por, ky akt lidhet vetëm me caktimin e minutave të subjekteve zgjedhore për të bërë fushatë në radiotelevizionin publik. Për sa i përket pikës 2?

Znj. V. Ballgjini: Për sa i përket pikës 5 të nenit 84 të gjitha televizioneve private i është bërë një njoftim edhe nga ana jonë për të përmbushur këtë detyrim që kanë ndërmjet KQZ-së që duhet të sjellin të gjitha tarifat. Një pjesë shumë e madhe e televizioneve i kanë sjellë dhe po bëhet publikimi i tyre në faqen zyrtare të KQZ-së. Dje kanë ardhur pjesa më e madhe e radiotelevizioneve private.. tarifat.

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

(ndërrhyrja nuk dëgjohet)

Dje kanë ardhur të përfunduara edhe sot po bëhen publike në faqen zyrtare të KQZ-së.

Z. I. Celibashi: Domethënë, vetëm dje i kanë sjellë. I kanë sjellë në vazhdim, por vetëm dje i kanë sjell në mënyrë të plot gati të gjithë.

Znj. V. Ballgjini: Po ka pasur në vazhdim dhe dje kanë sjell të plota pas një njoftimi të dytë që ju bë nga ana e KQZ-së për këtë detyrim që i lind atyre.

Z. I. Celibashi: Dakord, mirë këto duhet t'i publikojmë.

Znj. V. Ballgjini: Po, patjetër.

Z. I. Celibashi: T'jua dërgojmë zyrtarisht përfaqësueseve të partive politike. Por, gjithsesi në faqen e internetit së KQZ-së do të gjenden të gjitha informacionet si për këtë rast po ashtu edhe për raste të tjera, kandidat, të dhënat për kandidatët, për subjekte..

(ndërrhyrja nuk dëgjohet)


Po, këto sot publikohen ndoshta.

(ndërrhyrja nuk dëgjohet)

Z. I. Celibashi: Po, për ndryshe po jua dërgojmë edhe me email.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e Partisë LN: Faleminderit!

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*


Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësuesi i partisë Lëvizja Socialiste për Integrim.

Z. A. Kaziaj, përfaqësuese e Partisë LSI: Po, zoti Kryetar, faleminderit! Ajo që sapo relatoj një pjesëtar i administratës tuaj në këtë rast ka të bëjë me një akt të mëvonshëm që ne.. ju do merrni si dhënia e mundësisë subjekteve?

Z. I. Celibashi: Jo, ai është thjeshte për mbushjen e një detyrimi ligjor nga ana operatorëve radiotelevizivë për të treguar kostot dhe çmimet për transmetimet. Po ajo çfarë znj. Bushati tha ka të bëjë me faktin nëse ka nevojë për të rregulluar më shumë se çka rregulluar Kodi Zgjedhor raportin ndërmjet subjekteve zgjedhor dhe radiotelevizioneve private. Kjo ishte apo jo?

Z. A. Kaziaj, përfaqësuese e Partisë LSI: I kësaj ideje jam dhe unë zoti Kryetar. Për sa i përket fakti të televizioneve ne flasim për flasim për televizione kombëtare pikë së pari, pavarësisht se i ndajmë në publike apo jopublike. Fakti është që edhe nga një perceptim të themi deri diku vetjak i këtyre radiotelevizioneve pjesa e përqasjes që ato kanë ose shikueshmëria që kanë tek qytetarët shqiptarë është më i lart ai i televizioneve private kombëtare, siç mund të jenë disa operator që nuk mund t'i përmend. Gjë që do të përmbushte në thellësinë e vetë atë që është mesazhi që do të përcjelli një subjekt politik nëpërmjet qëndrimeve të veta politike ose platformës së vetë tek qytetarët. Në këtë rast mund ta themi kështu shfrytëzojmë më mirë duke bërë dhe një akt tjetër duke vënë në dispozicion dhe këto televizione për përcjelljen e këtyre mesazhe politike.

*Zbardhi materialin audio
Jonida SALILLARI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

Z. I. Celibashi: Dakord, e konsiderojmë nëse është e domosdoshme për të bërë një akt tjetër të KQZ-së në lidhje me këtë aspekt rregullator të Kodit Zgjedhor, pse jo. Mirë, kemi diskutim tjetër në lidhje me këtë akt. Nuk kemi.

Atëherë, bazuar në neni 19 pika 1 shkronja “ë” dhe “n”, paragrafi 2 si dhe neni 80 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, vendos:

1. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 90 (nëntëdhjetë) minutash, përkatësisht 60 (gjashtëdhjetë) minuta në Televizionin Publik dhe 30 (tridhjetë) minuta në Radion Publike , për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të subjekteve zgjedhore si më poshtë:

a) Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim (PD-PR-PDIU-PAAPBDNJ-PDK-LZHK-PLL-FRD-BLD-PBKD-PBD-PKD)”,

b) Partia Socialiste e Shqipërisë.

2. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 45 (dyzetë e pesë) minuta përkatësisht 30 (tridhjetë) minuta në Televizionin Publik dhe 15 (pesëmbëdhjetë) minuta në Radion Publike , për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të partive parlamentare si më poshtë:

a) Partia Socialdemokrate,

b) Lëvizja Socialiste për Integrim.

3. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 20 (njëzetë) minuta përkatësisht 10 (dhjetë) minuta në Televizionin Publik dhe 10 (dhjetë) minuta në Radion Publike , për pasqyrimin e fushatës zgjedhore të partive joparlamentare dhe koalicionit, si më poshtë:

a) Partia Lëvizja për Ndryshim,

b) Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare,


c) Partia Bindja Demokratike,

ç) Partia Balli Kombëtar,

d) Partia Lëvizja e Re,

Zbardhi materialin audio

Jonida SALILLARI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

dh) Partia Aleanca Demokracia e Re,

e) Partia Nisma Thurje,

ë) Koalicioni "ABEOK".

4. Caktimin e një minutazhi kohor transmetimi të barabartë prej 10 (dhjetë) minuta përkatësisht 5 (pesë) minuta në Televizioni Publik dhe 5 (pesë) minuta në Radion Publike , për pasqyrimin e fushatës zgjedhore për secilin prej 5 (pesë) kandidatëve të pavarur,

a) Elton Lahim Debreshi,

b) Kreshnik Luan Merxhani,

c) Iljaz Jashar Shehu,

ç) Bojken Xhelal Abazi,

d) Pal Marash Shkambi.


5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga data e shpalljes. Faleminderit!

Vendimi nr. 170

Zbardhi materialin audio

Jonida SALILLARI



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

23.03.2021
Ora 14:35

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e sasisë së vulave të komisionit të qendrës së votimit që do të prodhohen për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, E. Allushi, V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PSD, LSI, PDIU, LN,**
- **Koalicione:** **ABEOK, ADR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër!

Z. Y. Merkaj: Atëherë Komisioni Rregullator me vendim nr.11 datë 20.08.2000 ka caktuar rregullat për administrimin e shpërndarjes e vulave rezervë në Komisionet e Qendrave të Votimit. Komisioni Rregullator me vendimin nr.5 datë 19.02.2021 ka përcaktuar se KQZ prodhon vula rezervë me tekst unik për zëvendësimin e vulës së Komisionit të Qendrës së Votimit apo vulës së Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit të nxjerrë nga përdorimi. Gjithashtu autorizimin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, numrin e vulave rezervë që do të prodhohen në rang vendi si dhe formate tekste dhe numrin serial të çdo vule rezervë. Në bazë të përcaktimit të vendimit të sipër cituar vlerësohet se përzgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021 të prodhojnë 60 vula rezervë për të cilat mund të lind nevoja

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

për t'u përdorur nga Komisioni i Qendrës së Votimit. Sasia e vulave rezervë është llogaritur në bazë të numrit të Qendrave të Votimit si rang vendi për cdo Zonë të Administrimit Zgjedhorë. Nisur nga zgjedhjet e mëparshme vulat rezervë të Komisionit të Qendrave të Votimit janë përdorur në një numër shumë të kufizuar. Për këto arsye i propozoj KQZ të miratoj projektvendimin e mësipërm. Bashkëlidhur kemi projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, faleminderit!

Z. I. Celibashi: Faleminderit, përfaqësues të partive politike për këtë projektaktin?

Z. Sh. Sulo përfaqësues i PDIU-së: Zoti kryetar unë në parim jam dakort me këtë projektakt pasi vijmë në bazë të Kodit Zgjedhor por unë do të kisha një pyetje? Meqenë se këtu janë përcaktuar të gjitha mënyrat specifikimit, largësit, nëse këto nuk zbatohen nga subjektet zgjedhore. A duhet të përcaktojmë sanksionet në këtë rast? A lind nevoja që në këtë projektakt ne të vendosim një pikë sanksioni nëse nuk zbatohen?

Z. I. Celibashi: Ky më shumë është detyrim për KQZ.

Z. Sh. Sulo përfaqësues i PDIU-së: Sepse meqë fushata do të eci, do të bëhët më e nxhehtë normalisht do kemi dhe pjesë të ankimimeve por dhe veprime të tjera. Nëse ne e caktojmë këtu një pikë sanksionet, atëherë do ishte me produktive madje s'do kishim një seri ankimesh mendoj unë.

Z. I. Celibashi: E kap Kodi Zgjedhor këtë, kështu nëse do Rregullatori mund të nxjerrë ndonjë akt për këtë!




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

Z. Sh. Sulo përfaqësues i PDIU-së: Dakord!

Z. I. Celibashi: Do t'ua përcjellim atyre kolegëve të Rregullatorit. Faleminderit, diskutime të tjera nuk kemi. Mirë, atëherë bazuar në nenin 19 paragrafi 1 germa "n" dhe pika 2 neni 103 paragrafi 1, 2 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë vendos për zgjedhjet e datës 25 prill 2021 në rang vendi do të prodhohen 600 vula rezervë të komisioneve të qendrave të votimit. Formatit dhe specifikimet e vulës rezervë të komisionit të qendrës së votimit të jenë sipas lidhjes nr.1, teksti i vulës rezervë të qendrës së votimit është unik për çdo vulë dhe përbëhet nga shkronja "r" dhe një numër serial 4 shifror. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, faleminderit!

Vendimi nr.171

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

**23.03.2021
Ora 14:38**

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për përcaktimin e sasisë së fondit publik që do tu shpërndahet si paradhënie partive të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021”.

PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z. Ilirjan Celibashi**
 2. Staf i KQZ: **Y. Merkaj, M. Koja, E. Allushi, V. Ballgjini**
- **Parti Politike:** **PSD, LSI, PDIU, LN**
- **Koalicione:** **ABEOK, ADR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës!

Z. Y. Merkaj: Neni 18, paragrafi 1 shkronja “k” dhe “m” e Kodit Zgjedhor parashikon kompetencën e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve. Përcaktimin e masës së fondit publik që do të shpërndahet si paradhënie partive të regjistruara si subjekte zgjedhore, i cili administron buxhetin e KQZ si dhe ushtron në emër të KQZ kompetencat që i ngarkohen asaj me ligje të veçanta si dhe çdo kompetencë që ky ligj nuk ja njeh shprehimisht rregullatorit dhe KAS. Neni 96 shkronja “a” e Kodit Zgjedhor parashikon si burime të financimit të fushatës për subjektet zgjedhore fondet të dhëna paradhënie nga buxheti i shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore. Gjithashtu neni 88 dhe 180 i Kodit Zgjedhor ka përcaktuar mënyrën e përlogaritjes për ndarjen e fondeve me shumë që i takon

**Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

secilës parti për të marrë paradhënie. Objekti i këtij projektvendimi është caktuar në mënyrën e përlllogaritjes dhe kriteret për shpërndarjen e fondeve paradhënie për subjektet zgjedhore të regjistruara për caktimin e subjektit zgjedhor që ju lind e drejta të përfitojnë fonde paradhënie si dhe modalitetet dhe detyrimet që u lindin subjekteve zgjedhore për pranimin ekëtyre fondeve. Projekt akti caktues i subjekteve zgjedhore që u lind e drejta të përfitojnë fonde paradhënie, duke ju referuar rezultateve zgjedhore në zgjedhjet e kaluara. Mënyra e përlllogaritjes së fondeve është bërë duke ju referuar çdo partie politike që në zgjedhjet e vitit 2015, 2017,2011 kanë arritur të marrin jo më pak se 1% të votave në shkallë vendi. Referencë për përlllogaritjen e votës, e vlerës së votës është konsideruar viti në të cilin partia politike ka patur rezultate më të larta në numër votash, në zgjedhjet e viteve 2015 dhe 2017. Nga kjo përlllogaritje përjashtojmë partitë politike që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e vitit 2017 dhe 2015 dhe që nuk kanë arritur të marrin 1% të votave në shkallë vendi edhe pse në zgjedhjet e vitit 2019 kanë marrë jo më pak se 1% të votave . Gjithashtu përfshihet rezultati i partive politike të cilat nuk marrin pjesë ne zgjedhjet e vitit 2015 dhe 2017 por në zgjedhjet e vitit 2019 kanë marrë jo më pak se 1% të votave. Referuar pikës 4 të nenit 180 të Kodit Zgjedhor për zgjedhjet e para pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Kodit, fondi nga buxheti shtetit është 2 herë më i madh se fondi i akolokuar për zgjedhjet e mëparshme të vitit 2017. Shuma e përcaktuar për të marrë paradhënie çdo subjekt zgjedhor është përlllogaritur duke mbledhur totalin e votave të vlefshme dhe duke pjestuar me fondin e caktuar nga buxheti i shtetit. Për çdo subjekt zgjedhor i takon të marrë paradhënje sasinë e votave të marra shumëzuar me vlerën e një vote. Në zgjedhjet pararendëse mënyra e përlllogaritjrs për ndarjen e fondeve të buxhetit të shtetit për zgjedhjet e vitit 2017 është përlllogaritur duke referuar në zgjedhjet më të përiferhta të atij lloji pra zgjedhjet e vitit 2013 në ndryshim nga kjo përlllogaritje këtë vit

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

zbatohen dispozita tranzitore për financimin nga buxheti i shtetit pikërisht është neni 180 i Kodit Zgjedhor. Për sa me lart paraqes relacionin për miratim.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit, përfaqësues të partive politike për diskutim në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës? Nuk kemi! Atëherë bazuar në nënin 19 paragrafi 1 shkronja “k” dhe “m”, paragrafi 2 neni 86, neni 88 dhe 180 të Kodit Zgjedhor të Republikës të Shqipërisë dhe udhëzimi nr. 8 datë 16.02.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për miratimin e aktmarveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe partisë politike që përfitojnë fonde nga buxheti i shtetit dhe KQZ vendos:

1. Të shpërndajë si paradhënie fondet e vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit, partive politike, pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi të cilën po e lexojmë:

- 1.Partia Demokratike 33.318.149 lekë.
- 2.Partia Republikane 3.926.232 lekë.
- 3.Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar 143.412 lekë.
- 4.Partia Socialiste e Shqipërisë 55.826.750 lekë.
- 5.Partia Lëvizja Socialiste për Integrim 18.975.182 lekë.
- 6.Partia për Drejtësi Integrim dhe Unitet 5.552.885 lekë.
- 7.Partia Fryma e Re Demokratike 2.188.832 lekë.
- 8.Partia Demokristiane 1.479.742 lekë.
- 9.Partia Social Demokrate 1.629.360 lekë.
10. Partia Bindja Demokratike 1.485.550 lekë.

Në total ky fond është 125.816.694 lekë, ky është fondi që përfitojnë partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje si paradhënie.

Vendimi nr.172

*Zbardhi materialin audio
Albana NDOCI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

**23.03.2021
Ora 14:44**

RENDI I DITËS

Projektudhëzim “Për përdorimin e materialeve propagandistike zgjedhore, materialeve edukative dhe afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, V.Ballgjini

• **Parti Politike: LSI, PDIU, PSD,**

Koalicione: ABEOK, ADR

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër.

Z. Y. Merkaj: Neni 76, pika “1” dhe “10” e Kodit Zgjedhor parashikon se gjatë fushatës zgjedhore, çdo subjekt zgjedhor ka të drejtë të bëjë propagandë zgjedhore në mënyrë të ligjshme. Nuk përbën shkelje dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët lejohen të ofrojnë sende dhe materiale të printuara fushate ku vlera e tyre është më e vogël se 500 lekë, për çdo send apo material. Neni 76 i Kodit Zgjedhor përcakton materialet propagandistike, kufizimet dhe përdorimet e tyre gjatë fushatës zgjedhore nga subjektet zgjedhore. Objekti i këtij projektudhëzimi është përcaktimi i kriterëve të vendndodhjes së zyrave zgjedhore, kriteret për përdorim të materialeve propagandistike dhe përcaktimi i listës së sendeve apo materialeve të lejuara për fushatë në vlerë maksimale për secilën prej tyre. Projektudhëzimi ka për qëllim përcaktimin e rregullave që do të ndiqen nga subjektet zgjedhore në

**Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi SINO**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

përdorimin e materialeve propagandistike, caktimin e vendeve publike të lejuara. Pra afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore, monitorimin dhe zbatimin e tyre. Risitë në këtë projektudhëzim janë si vijon:

Përkufizimi i termit “zyrë zgjedhore, përcaktim i listës së sendeve apo materialeve të lejuara për fushatë me vlerë jo më të madhe se 500 lekë për secilin prej tyre, ndalimi i afishimit të materialeve propagandistike në fasadë apo godinave të banimit, insitucioneve publike apo ambjenteve rrethuese pranë tyre brenda zonave rikreative, parqeve dhe pemëve të qytetit si dhe shtyllat e ndriçimit, ndalimi i vendosjes së materialeve propagandistike në mjete që operojnë në transportin publik”. Për këtë projektudhëzimi i është dërguar subjekteve të interesuara, organizatës, shoqërisë civile dhe në përgjigje të kërkesës tonë NDI-ja ka parashtruar një kërkesë e cila vendoset, një normë në lidhje me zyrat zgjedhore me arsyetimin që mund të ketë ndonjë lagje ose ndonjë fshat. Një subjekt zgjedhor mund të ketë vetëm një zyrë zgjedhore. KQZ-ja vlerëson sugjerimin e përcjell nga NDI-ja gjatë analizës për ankimin e projektudhëzimit u muar në konsideratë edhe parashikimi i mëparshëm për përcaktimin e një numri maksimal të zonave të zyrave zgjedhore për çdo subjekt zgjedhor duke reflektuar frymën e re të Kodit Zgjedhor, i cili përcakton një tavan në lidhje me shpenzimet e fushatës zgjedhore, i cili ka pësuar ulje në krahasim me parashikimet e mëparëshme duke vendosur kufirin e sipërm prej 3 herë më të madhe se shuma më e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike. Gjithashtu ka parashikuar edhe votën preferenciale për kandidatët e listave shumëmemërore të subjekteve zgjedhore. KQZ-ja disponon se në analizën e parashikimeve ligjore të mësipërme do të ishte në vlerësim të subjekteve zgjedhore përcaktimi i strategjive propaganduese duke përlllogaritur në bazë të kufirit maksimal të shpenzimeve të lejuara sipas Kodit

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi SINO*



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021**

Zgjedhor dhe fondeve që ata disponojnë. Bashkëlidhur keni projektudhëzimin për shqyrtim dhe miratim si dhe materialialet përkatëse, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Mirë, faleminderit. Përfaqësues të partive politike? Po përfaqësuesi i LSI-së.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Një pyetje për Sekretarin e Përgjithshëm ju thatë që MBI kishte bërë një kërkesë për pasqyrimin e një sugjerimit të tyre. Në cilin nen është pasqyruar kjo, zoti sekretar?

Znj. M. Koja: Sugjerimi nuk është marrë në konsideratë dhe është dhënë shpjegimi përkatës relacionit ashtu si relatoi Sekretari i Përgjithshëm me ato argumente që ai përmendi.

Z. A. Kaziaj, përfaqësuesi i LSI-së: Faleminderit edhe diçka tjetër zoti Komisioner. Në lidhje me mënyrën sesi procedojnë mbledhjet e Komisionit Rregullator pranë këtij komisioni duke qenë se akti është i një rëndësie të veçantë, nëqoftëse na mundësohet nga pjesa e administratës leximi nen për nen, në mënyrë që të bëjmë dhe një pasqyrim të mundshëm në lidhje me gjetjet tona.

Z. I. Celibashi: Po, patjetër që do kalojmë në leximin nen për nen.

Neni 1 objekti dhe qëllimi: Objekti i këtij udhëzimi është:

1. Përcaktimi i kriterëve të vendndodhjes së zyrave zgjedhore, kriteri për përdorim materiale propagandistike edukuese dhe përcaktimi i listës së sendeve apo materialeve të lejuara për fushatë me vlerat maksimale për secilën prej tyre.

**Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi SINO**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

2. Ky udhëzim ka për qëllim përcaktimin e rregullave që do të ndiqen nga subjektet zgjedhor në përdorim të materialeve propagandistike, caktimin e vendeve publike të lejuara për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore, monitorimin dhe zbatimin e këtyre rregullave nga kryetarët e bashkive dhe KQZ. Kemi ndonjë diskutim për këtë nen?

Z. A. Kaziaj, përfaqësuesi i LSI-së: Jo.

Z. I. Celibashi: Kalojmë tek neni tjetër. Neni 2. Ka të bëjë me përkufizimet në këtë udhëzim, termat e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. Materiale propagandistike statike kanë të njëjtin kuptim si me vendimin nr.12 datë 30.12.2020 të Komisionit Rregullator “për miratimin e rregullave të veprimtarisë së Policisë së Shtetit në shërbim të zgjedhjeve”.
2. Materialet edukuese zgjedhor janë materiale që i shërbejnë edukimit të zgjedhësve lidhur me të drejtat e tyre, procedurat e regjistrimit dhe mënyrës së votimit dhe aspekte të tjera parashikuar në Kodin Zgjedhor. Zyrat zgjedhore janë mjediset, apo zyrat që përdoren nga subjektet zgjedhore apo kandidatët e tyre për qëllime të fushatës zgjedhore.

Pika 3 neni 3. Për afishimin e materialeve propagandistike. Kryetari i Bashkisë në mënyrë të drejtë dhe të paanshme jo më vonë se 35 ditë përpara ditës së zgjedhjeve, përcakton vendet publike me territorin e bashkisë përkatëse për afishimin e materialeve propagandistike. Materialet propagandistike zgjedhore lejohen të afishohet në një distance deri 5 metra nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës, jo më parë se 30 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Në mbarimin e fushatës zgjedhore subjektet zgjedhore marrin masat për heqjen e gjithë materialeve propagandistike.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

2. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në fasadat e banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë dhe rreth tyre brenda zonave rikreative, parqeve, pemët e qyteti dhe shtyllat e ndriçimit. Ndalohet vendosja e materialeve propagandistike në mjete që operojnë në transportin publik vende të caktuara në pikën "1" të këtij neni duhet të jenë në mjedise që sigurojnë shikueshmëri publike dhe të kenë hapsirë të mjaftueshme që të gjitha subjektet zgjedhore që marrin pjesë në zgjedhje të mund të paraqesin material propagandistike, të paraqesin programet e tyre zgjedhore dhe ose mesazhet zgjedhore.

Pika 5 e këtij neni. Vendet publike në territorin e bashkisë të dedikuara për afishimin e materialeve propagandistike duhet t'u shpërndahen subjekteve zgjedhor në mënyrë proporcionale duke shmangur dhënien e përparësisë për ndonjë prej subjekteve zgjedhorë.

6. Kryetarët e Bashkive duhet të marrin masa për të mos lejuar apo heqin menjëherë çdo material statik përfshi posterave dhe flamuj në çdo vendodhje tjetër që nuk janë vendosur në përputhje me kriteret e këtij udhëzimi.

7. Vendimi i Kryetarit të Bashkisë për caktimin e vendeve për afishimin e materialeve propaganduese bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë menjëherë pas miratimit të tij dhe një kopje e tij njoftohet Komisioneri Shtetëror për zgjedhjet brenda 24 orëve nga miratimi. Vendimi i marrë nga Kryetarët e Bashkive përpara miratimit të këtij udhëzimi, rishikohet në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzim.

8. Subjekteve zgjedhore u lejohet të afishojnë materiale propagandistike vetëm në vendet e përcaktuara nga Kryetari i Bashkisë sipas këtij neni dhe marrin masa për heqjen e tyre me përfundimin e fushatës zgjedhore. Ngarkohet Policia e Shtetit për zbatimin e pikës 8 të këtij neni. Kemi ndonjë diskutim?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Po, diçka të vogël duke marrë parasysh dhe godinën time të banimit, ndalohej afishimi i materialeve propagandistike në fasadat e godinave të banimit kur godinat sot janë edhe me karakter multifunksional. Përshembull qendrat tregtare si do i konsiderojmë?

Z. I. Celibashi: Sipas këtij akti e kemi të ndaluar. Ato LED wall-et që janë nëpër fasada, janë pronë private dhe kanë një rregullim tjetër. Ato janë “gia” të vendosura. Nëse është një fasadë e një qendre tregtare apo dhe një godinë tjetër publike aty nuk mund të lejohen të vendosen. Ky është kuptimi, kurse kontenti i LED wall-eve është tjetër gjë.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Këtu thuhet “Të gjitha materialeve propagandistike vizive” dhe këtu lejohet dhe një reklamë e vënë në to.

Z. I. Celibashi: Po për to, ai e ka “gia” lejen për ta vendosur LED wall-in në mur.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Edhe një saktësim. Pika 7 mund të ketë kundërshtime për këtë vendim?

Z. I. Celibashi: Do ankohesh te Komisioneri Shtetëror nëse mund ta përdorësh këtë term.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Mund ta cilësojmë këtu, mbi këtë?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

Z. A. Kaziaj, përfaqësuesi i LSI-së: Është në fund. Ne kemi konstatuar se disa bashki nuk e kanë një faqe internet dhe ndërkohë në pikën 7 ne pasqyrojmë si detyrim të Kryetarëve të Bashkive. Po të shikoni vet, tek 128-a, vetë KQZ-ja për dërgimin e një shkrese për të rregulluar situatën e tyre në këtë rast dhe një vendim i juaji, e ka sjell në vëmendje lidhur me Kyetarin e Bashkisë Vorë i cili nuk e ka një faqe interneti për bashkinë e tij.

Z. I. Celibashi: Ke të drejtë, do e vlerësojmë këtë thirrje bazuar në kërkesën dhe ankesën tuaj. Ne ia kemi sjellë në vëmendje dhe shpresojmë të reagojë dhe përgjigjet pozitivisht kërkesës sipas ligjit. Bazuar dhe në nevojën e këtij akti shpresojmë të reflektojmë pas një kërkesë apo adresimi të ri që do t'i bejmë ne.

Kalojmë tek neni 4. "Caktimi i vendeve për afishimin e materialeve edukuese zgjedhore". Afishimi i materialeve edukuese zgjedhore në dispozicion të KQZ-së ose palëve të treta që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar bëhet në vendet e caktuara nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

Pika 2.Vendi i materialeve edukuese dhe informuese sipas pikës 1 të këtij neni si rregull duhet të jetë me akses të lartë për publikun dhe hapësirë të bollshme për afishimin e të gjithë materialeve edukuese.

Kalojmë tek neni 5. "Zyrat zgjedhore". Zyrat zgjedhore të subjekteve zgjedhor mund të hapen në një distancë jo më të vogël se 150 metra nga vendodhja e KZAZ-ve, qendrave të votimit dhe vendeve të numërimit të votimeve.

2. Subjekti zgjedhor njofton me shkrim Kryetarin e Bashkisë përkatëse dhe vë në dijeni KQZ-në për hapjen e zyrave zgjedhore dhe për adresat e sakta të tyre jo më vonë se 35 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Administrata e bashkisë përkatëse jo më vonë se 5 ditë nga marrja e informacionit bën verifikimin e vendndodhjes së zyrave elektorale dhe të respektimit të dispozitave të këtij udhëzimi për afishimin e

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

materialeve propaganduese. Policia Bashkiake garanton zbatimin e detyrimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni me kërkesë të KQZ-së. Jemi dakord?

Z. A. Kaziaj, përfaqësuesi i LSI-së: Më falni pikës 4 po ia lemë kompetencë Policisë Bashkiake në këtë rast, ku në një nen të mëparshëm ia kishim lënë Policisë së Shtetit. Ku është ndryshimi midis kësaj përgjegjësie? Mund të ndodhi që në bashki të caktuara Policia Bashkiake bëhet ushtar i Kryetarit të Bashkisë dhe nuk procedon.

Z. I. Celibashi: Komenti është me vend por në momentin kur do ketë një akt nga ana e KQZ-së, e Komisionerit për ta ekzekutuar këtë akt. Policia Bashkiake nëse nuk do përgjigjet do të ketë përgjegjësi sipas Kodit Zgjedhor. Dëgjojmë një sqarim.

Znj. M. Koja: Për të vijuar argumentin e Komisionerit dhe për të dhënë dhe ju një sqarim pse në nenin 3 në pikën 9 është referuar Policia e Shtetit për zbatimin e pikës 3 të këtij neni sepse nëse shikojmë tek pika 3 e nenit 3 ndalohet vendosja e materialeve propagandistike në mjetet që operojnë në transportin publik. Në transportin publik i cili mund të jetë qytetas por dhe ndërqytetas dhe duke pasur parasysh kryesisht transportin ndërqytetas, ku kompetencat janë të kufizuara janë në bazë të kompetencave territoriale të tyre. Në këtë rast është e nevojshme të ndërhyjë Policia e Shtetit.

Z. A. Kaziaj, përfaqësuesi i LSI-së: Unë mendoj në çdo rast duhet të ndërhyjë Policia e Shtetit sesa Policia e një Bashkie të caktuar. Ne jetojmë në Shqipëri dhe e dimë mirë si funksionon, marrin urdhëra verbal dhe nuk i zbatojnë kërkesat e ligjit.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

Z. I. Celibashi: Dakord, nuk kemi si ta fshehim si realitet, por nga ana tjetër nuk kemi si ta zhveshim nga përgjegjësia Policinë Bashkiake. Ajo, çka duhet të bëjë Policia Bashkiake bazur një urdhërimi të Komisionerit është në përmbushje të përgjegjesive të saj si Polici Bashkiake. Në këtë rast, nëqoftëse nuk do ta zbatojë KQZ-ja, Komisioneri bazuar në Kodin Zgjedhor ka të drejtën të vendosi sanksione. Shkon më shumë për Policinë Bashkiake si kompetencë sepse ajo është kontrolluesja e territorit për këtë aspekt. Në këtë rast ka mundësi ligjërisht të vendoset një sanksion ndaj Policisë Bashkiake nëse nuk ekzekuton urdhërimin e Komisionerit. Në çdo rast, do të zgjidhnim kujt do t'i vinim gjobën, Policisë së Shtetit apo Policisë Bashkiake. Veprimatria që do të kryente në këtë rast Policia Bashkiake nuk do të ishte në përputhje më detyrimet e saj për këtë rast vetëm. Sikurse ishte ajo çka drejtoresha tha për mjetet e transportit që është përgjegjësia e Policisë së Shtetit dhe Policisë Rrugore.

Z. Sh. Sulo, përfaqësuesi PDIU-së: Një sqarim në lidhje me nenin 5 pika 1 që thotë “ Zyrat e subjekteve zgjedhore mund të jenë në një distancë jo më të vogël se 150 metra” nëse do të shikohej e arsyeshme nga unë do të propozoja një distancë deri në 300 metra, pasi në qendrat e votimit dhe KZAZ-ve vendoset dhe perimetri i perosnave që ruajnë dhe sigurinë për këto institucione. Në këte distancë i bie që punonjësit e sigurisë të jenë brenda zyrave të subjekteve zgjedhore. Nëse do të ishte e mundur do të propozoja që kjo distancë të ishte 300 metra. Dua të di dhe arsyetimin pse është 150 metra. Nga përvoja kemi parë që nga zyrat zgjedhore janë qëlluar dhe me gurë, për të shmangur këto incidente do të propozoja një distancë pak më të madhe, faleminderit.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi SINO*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike së
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

Z. I. Celibashi: Më fal zonja Bushati ti japim një sqarim kësaj.

Znj. M. Koja: Kodi nuk përcakton ndonjë kufi në lidhje me distancën. Ky është një rregullim që përcakton ky udhëzim. I jemi referuar distancës prej 150 metra sepse është një standard që kodi e njeh jo për rastin e zyrave zgjedhore por dhe vendimi i Komisionit Rregullator në lidhje me rolin e Policisë së Shtetit në zgjedhje dhe ligji, Kodi Zgjedhor e ka si marzh, përcakton dhe ne ju referuam si standard që kodi e njeh dhe jemi të hapur për të përcaktuar dhe një distancë tjetër, për sa kohë nuk ka ndalim kodi për këtë.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Silvi SINO*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

Z. I. Celibashi: Unë mendoj se është shumë e dobishme për integritetin e procesit zgjedhor nëse vendosim një distancë pak më të madhe. Le ta vendosim jo më pak se 300 metra. Ky ishte propozimi, e pranojmë propozimin e përfaqësuesit të Partisë Drejtësi Integrim dhe Unitet.

Z. Sh.Sulo, përfaqësues i PDIU-së: Faleminderit!

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Për t'u rikthyer pak asaj se çfarë tha kolegu. Këtu neni 79 thotë e ka lënë vetë evazive Policia Bashkiake ose dhe Policia e Shtetit, meqënëse akti quhet udhëzim nuk shoh arsye pse në akt si të thuash meqënëse është udhëzim të ketë një përcaktim se kush bën çfarë në varësi të nenit. Mendoj që një formulim më i saktë do të ishte në çdo rast kur është parashikuar ose Policia e Shtetit ose Policia Bashkiake, të formulohet, ngarkohet Policia Bashkiake ose dhe Policia e Shtetit të garantojnë zbatimin e përcaktimit të bëra në këtë nen sipas vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Pastaj është Komisioneri ai që vlerëson se cila është kompetenca e secilës polici po themi në varësi të rastit.

Znj. M. Koja: Duke falenderuar për sugjerimin doja thjesht të sillja në vëmendje që neni 7 të projektudhëzimit, përcakton se për zbatimin e tij ngarkohen kryetarët e bashkive, subjektet zgjedhore, punonjësit e Policisë Bashkiake dhe të Policisë së Shtetit si dhe monitoruesit e caktuar nga KQZ-ja. Pra për të gjithë udhëzimin janë këto organe të ngarkuara për zbatimin e tij dhe nuk mendoj se është me vend që ta pasqyrojmë këtë në çdo nen të tij. Besoj se është e mjaftueshme sa është parashikuar në nenin 7.

*Zbardi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

Z. A.Kaziaj, përfaqësues i LSI: Është me vend heqja e pikës 4 në këtë pjesë, të nenit 5. Duke qenë se ju ngarkoni në nenin 7 për zbatimin e të gjithë detyrimeve të udhëzimit, pse në pikën 4 të nenit 5 e heqim fare, dhe të gjitha këto subjekte të pikës 7 janë të ngarkuar nga udhëzimi..

Znj. M. Koja: Sepse është specifike, pika 3 nënta referon vetëm tek pika 3 dhe aty nuk ka kompetencë Policia Bashkiake.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Ky udhëzim është i Komisionerit që do të thotë që udhëzimi do të dalë në bazë e për zbatim të ligjit dhe ligji ty të kalon në kompetencën që në varësi të rastit të jetë ose Policia Bashkiake ose e Shtetit ose madje të dyja bashkë.

Znj. M. Koja: Prandaj dhe ne në frymë të këtij neni kemi detajuar prandaj është udhëzimi me gjetjet përkatëse kur është roli i njëjës polici dhe kur është roli i policisë tjetër.

Znj. E. Bushati, përfaqësuese e LN-së: Ju tek pika 3 nuk e keni specifikuar a është transport publik urban. Pse duhet të jetë Policia e Shtetit kur mund të jetë dhe Policia Bashkiake? Se shpjegimi që dhatë më përpara ishte për atë ndërurban, ndërqytetas. Për ndërqytetas ka kuptim që të jetë Policia e Shtetit, po për atë urban si do e lemë tani?

Znj. M. Koja: Nuk përjashton përgjegjësinë e Policisë Bashkiake sepse neni 7 e përfshin atë. Ne kemi dashur të evidentojmë rolin e Policisë së Shtetit në rastet kur nuk ka kompetencë Policia Bashkiake.

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

Z. I. Celibashi: Duhet të kuptojmë një gjë se mund ta vendosim dhe Policinë e Shtetit dhe është një fakt që të gjithë kemi një konfidencë më të madhe te Policia e Shtetit. Për rastin e mjeteve të transportit, kompetencat e Policisë Bashkiake janë shumë të limituara. E gjithë çështja e qarkullimit të respektimit të rregullave të qarkullimit rugor se çfarë mban makina e tjerë janë përgjegjësi e Policisë së Shtetit. Për sa i përket këtij përjashtimi të themi që ka pika 4 e nenit 5, po e lexoj dhe një herë Policia Bashkiake garanton zbatimin e detyrimit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni me kërkesë të KQZ-së. Kush është pika 1 e këtij neni? Pika 1 e këtij neni ka të bëjë me zyrat zgjedhore të subjekteve zgjedhor, mund të hapen një distancë. Kjo është çështje tërësisht e organeve të qeverisjes vendore dhe nuk do të ishte mirë që të fusim Policinë e Shtetit te kjo gjëja. Ajo ka të bëjë si të thuash po e marr shembullin trashë për ta kuptuar në një lloj leje për të ushtruar një aktivitet të caktuar në një objekt të caktuar, në një njësi të qeverisjes vendore të caktuar dhe kjo është kompetencë e bashkisë. Nuk kemi pse të fusim Policinë e Shtetit për t'i thënë dikujt një subjekti politik që mos e vendosë këtu zyrën po vendose atje. Mund të jetë një pretekst... Vetëm për rastin e zyrave.

Z. A.Kaziaj, përfaqësues i LSI: Fakti është se zyrat përveç zyrës së parashikuar qendrore ose rajonale vendore për subjektin që është në detyrim për bashkitë dhe Ministrinë e Brendshme për krijimin e kushteve të vëna në dispozicion. Si rregull subjekti zgjedhor merr një zyrë te një palë private me të cilën lidh një kontratë kuopërdorje qiraje. Policia Bashkiake çfarë kompetencash mund të ushtrojë mbi këto palë? Mund të ushtrojë vetëm mbi subjektin që hap zyrën apo mbi palën mbi të cilën është marrë zyra? Kush do të jetë personi përgjegjës? Nuk duhet ndërhyrja e një institucioni më kompetencë sesa Policia Bashkiake që mund të bëjë në fund

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*




*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

të fundit edhe diskriminim ose diferencim midis subjekteve dhe kjo është frika e madhe.

Z. I. Celibashi: Në asnjërën prej palëve nuk do të merret Policia Bashkiake, nuk ka asnjë lloj tagri për të thënë që pse ke marrë këtë pse ia ke dhënë këtë me qera, por Policia Bashkiake merret me atë që nëse ti vendos tek fasada e atij objekti një material që e identifikon atë si material propagandues i një subjekti zgjedhor shkon dhe i thotë që ti nuk mund ta vendosësh këtë, sepse je më pak se 300 metra nga distanca vetëm për këtë. Ti mund ta marrësh, mund të mbash një zyrë aty nëse nuk ke afishim propogantistik rreth e për qark asaj zyre je në rregull nuk ke asnjë lloj problemi, kjo është. Por nëse ti vendos një gjë jashtë në kundërshtim një material propagandistik në kundërshtim me përcaktimet e këtij udhëzimi. Atëherë është si një lloj ndërtime pa leje të themi dhe shkon punonjësi i Policisë Bashkiake ose ke vendosur një gjë një objekt që nuk do të duhet ta vendosje në rrugë, ke zënë rrugën atje mund të kesh vendosur një baner një city leight ose nuk e di se çfarë. Të gjitha këto shkojnë në kompetencën e Policisë Bashkiake. Pastaj Komisioneri e vlerëson nëse ka vend për të angazhuar në realizimin e urdhërimit të tij Policinë e Shtetit mund ta bëjë, sepse e ka rregullimin e përgjithshëm që angazhohet Policia e Shtetit, por për këtë rast është mirë që të ngelet në kompetencat e Policisë Bashkiake.

Z. A.Kaziaj, përfaqësues i LSI: Është një fakt shumë i thjeshtë, por ka shumë rëndësi që të krijohet preceptimi dhe bindja që jemi përpara një fakti të tillë zoti Komisioner që ndodhemi, të gjitha bashkitë janë në duar të një subjekti të vetëm politik. Si mundet të veprojë një polic bashkiak në kundërshtim me atë që verbalisht se normalisht me shkresë nuk ka sesi t'ia japë Kryetari i Bashkisë po

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

verbalisht do e urdhërojë ose do e porosisë. Ne këtë frikë kemi të një diferencimi të një trajtimi ndryshe, të një përdorimi jo të drejtë të armëve..

Z. I. Celibashi: Është e saktë dhe ne e pranuar këtë, por në çdo rast si Policia Bashkiake, si Policia e Shtetit do të veprojnë bazuar në urdhërimin e Komisionerit dhe nëse nuk do t'i përgjigjet urdhërimit të Komisionerit do të ketë penalitete. Në të dyja rastet si Policia Bashkiake ashtu dhe Policia e Shtetit.

Z. A.Kaziaj, përfaqësues i LSI: A mund ta saktësojmë pjesën e penaltetit dhe bazën ligjore përkatëse në pikën 4 në të kundërt në qoftë se nuk veprohet sipas urdhërimit të pikës 4 Policia Bashkiake mban përgjegjësi sipas nenit 171.

Z. I. Celibashi: Këtë mund ta shtojmë.

Znj. M. Kojaj: Doja të sillja në vëmendjen tuaj që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në rolin e Rregullatorit nëse lexojmë me kujdes pikën 2 dhe pikën 4 të nenit 5, do ta konstatojmë këtë gjë. Subjekti zgjedhor njofton me shkrim Kryetarin e Bashkisë përkatëse dhe vendin në KQZ. Gjithashtu investimi bëhet në pjesë të KQZ-së, pra KQZ-ja është garanti në këtë rast për të dhënë këtë sqarim më tej. Prandaj jemi në dijeni në çdo moment se ku vend ndodhen zyrat zgjedhore.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI: Ju e dini se njoftimi me shkrim bëhet në rrugë zyrtare ndërmjet shërbimit postar. Koha që na merr protokollimi i shkresave, përpilimi i saj, protokollimi tek ju, kthimi përgjigje nga ju. Mund të ndodhë që në ditët e fundit të fushatës zgjedhore të bëhen iniciativa abuzive nga ana e policisë për seleksionimin e disa subjekteve dhe ne nuk kemi kohën fizike dhe ju bashkë

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

me ne që të na ktheni përgjigje të merrni masa dhe ndërkohë që procesi është drejt përfundimit të tij drejt ardhjes të ditës së votimit. Ky është një shqetësim shumë i madh gjë që administrativisht nuk mund ta arrijmë në qoftë se strategjia e caktuar e një partie të caktuar mund të jetë kjo që unë sapo ju thashë.

Z. I. Celibashi: Po lexoj nenin 7 tani dhe po të shikojmë nenin kjo çfarë thamë pak më përpara për vendosjen e sanksioneve, unë mendoj se është e përcaktuar dhe nëse do të duhet t'i bëjmë një riformulim mund ta riformulojmë. Pra në rastin e moszbatimit të urdhërimeve të Komisionerit qoftë dhe në mënyrë të veçantë të posaçme e vlerëson rast pas rasti se tani e pashë. Atëherë kalojmë tek neni 6, subjektet zgjedhore kandidatët e tyre lejohen të ofrojnë sende dhe materiale të printuara fushate ku vlera e tyre është më e vogël se 500 lekë për send ose material. Lista e këtyre sendeve materialeve paraqitet në shtojcën që bashkëlidhet këtij vendimi.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI: Po në rast se jemi në situatën që kandidati i një subjekti i të njëjtit subjekti zgjedhor normalisht, ofron një ambient me qera për subjektin e vet zgjedhor. Si mund të trajtohet në këtë rast? Mos duhet të rritet pak 500 lekë për sende të luajtshme flitet 500 lekë? Në këtë rast se po flas unë janë sende të paluajtshme.

Znj. M. Koja: Është përcaktimi i Kodit pra lejohet vënia në dispozicion mund t'ua sjellë në mendje nenin përkatës? Nuk përbën shkelje dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët lejohen të ofrojnë sende dhe materiale të printuara fushate, kur vlera e tyre është më e vogël se 500 lekë për send ose material. KQZ mban dhe përditëson

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

listën e sendeve apo materialeve të lejuara për fushatë, pra neni 78 pika 10 e tij prajemi në këtë parashikim.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI: Domethënë 500 lekë për send ose material për një maskë me logo është një send apo jo që nuk mund të kalojë 500 lekëshin. Për gjëra të tjera mua më duket, pavarësisht se e ka Kodi duhet gjetur një mënyrë që të flitet edhe për pjesën jo vetëm e materialeve të lëvizshme ose të luajtshme po materialet e paluajtshme për pjesën e asaj që unë bëra si shembull. Kemi një rast konkret që një kandidat i një subjekti i jep me qera ose me urdhëra përdorjeje pjesës së partisë së vet një ambient për ushtrimin e aktivitetit politik.

Z. I. Celibashi: Kandidati e ka për vete atë..

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI: Do të bëj deklarin në këtë rast si i ka për vete. Po flisni për sende dhe këtu nuk flitet për sende. Sendet sipas Kodit Civil ndahen në luajtshme apo të paluajtshme.

Z. I. Celibashi: Kodi nuk e ka përcaktuar këtë. Ky akt nuk ka të bëjë me këtë.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI: E di që ai akt nuk ka të bëjë me atë që sapo thashë, këtë e hodha më shumë si ide në këtë rast...

Z. I. Celibashi: Ajo është çështje tjetër ka të bëjë me donacione të gjitha raportet e tjera ndërmjet shpenzimeve që kryhen subjektet e kandidatëve për fushatën zgjedhore. Por në këtë rast ka këtë përcaktimin.

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

Kalojmë te neni 7. “Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkojmë kryetarët e bashkive, subjektet zgjedhor, punonjësit e Policisë Bashkiake dhe të Policisë së Shtetit, si dhe monitoruesit e caktuar nga KQZ-ja. Mosrespektimi, moszbatimi i detyrimit të përcaktuar në këtë udhëzim përbën kundërvajtje administrative sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor”. Mendoj që kjo i përfshin të gjitha.

Neni 8. Udhëzimi nr.1, datë 31.05.2017 i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për përdorimin e materialeve propogantistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore” shfuqëzohet.

Neni 9. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

Udhëzim nr.6

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

23.03.2021
Ora 15:20

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për një shtesë në vendimin nr.151, datë 16.03.2021, “Për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të Misionit të ODIHR për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021”.


PJESËMARRJA :

- **KQZ**
 - 1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**
 - 2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, V.Ballgjini**
- **Parti Politike:** **LSI, PDIU, PSD,**
- **Koalicione:** **ABEOK, ADR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: KQZ me vendimin nr.151 datë 16.03.2021 ka miratuar 13 vëzhgues afatgjatë të Misionit ODIHR si dhe zonat e vëzhgimit të tyre për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Kjo organizatë ka paraqitur kërkesën për akreditimin e vëzhguesve afatgjatë si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit KQZ vëren se ai është i plotë dhe në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor si dhe nenit 4 të udhëzimit nr.2 të vitit 2021, të KQZ-së. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe listën e vëzhguesve afatgjatë të Misionit ODIHR, faleminderit.

*Zbardhi materialin audio
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

Z. I. Celibashi: Atëherë, në vendimin nr.151 datë 16.03.2021 për miratimin e vëzhguesve afatgjatë të Misionit të ODIHR për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021 bëhen shtesat si më poshtë:

1. Në listën e përcaktuar në lidhjen "1" bashkëlidhur vendimit nr.151 shtohen 24 vëzhgues afatgjatë;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr. 173

*Zbardhi materialin audio
Silvi Sino*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

23.03.2021

Ora 15:21

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të Fondacionit Shqiptar për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara(FShDPAK) për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ:

Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, V.Ballgjini

• **Parti Politike:**

LSI, PDIU, PSD,

• **Koalicione:**

ABEOK, ADR

Z. Y. Merkaj: Fondacioni Shqiptar për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesën për akreditimin e 16 vëzhguesve si dhe zonat e vëzhgimit për zgjedhjet për Kuvend të datës 25 prill 2021. Fondacioni Shqiptar për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka një eksperiencë disa vjeçare në pregatitjen e disa grupeve me Aftësi të Kufizuar në të gjitha proceset e votimit që pas vitit 2000. Nga shqyrtimi i dokumentacionit KQZ vëren se ai është i plotë dhe në përputhje me nenin 6, të Kodit Zgjedhor dhe nenit 4 të udhëzimit nr.2 të vitit 2021, të KQZ-së. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe listën e vëzhguesve afatshkurtër, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Atëherë, vendos:

Zbardhi materialin audio

Silvi Sino



**Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021**

1. Të miratojë kërkesën e Fondacionit Shqiptar për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FShDPAK) për akreditimin e 16 vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021 sipas listës të përcaktuar në lidhjen "1" bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr. 174

**Zbardhi materialin audio
Silvi Sino**



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

23.03.2021
Ora 15:22

RENDI I DITËS

Projektvendim “Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të Community Reporters për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, V.Ballgjini

• **Parti Politike: LSI, PDIU, PSD,**

• **Koalicione: ABEOK, ADR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Community Reports ka paraqitur pranë KQZ-së kërkesën për akreditimin e 8 vëzhguesve afatshkurtër si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Community Reports është një organizatë jo fitim prurëse e cila ka për qëllim promovimin e zhvillimit të gazetarisë qytetare në Shqipëri dhe të fuqizojë anëtarët e minoritetit Romë dhe Egjiptjan për t’u bërë zëra të përgjegjshëm qytetarë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, KQZ vëren se ai është i plotë dhe në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor si dhe nenit 4 të udhëzimit nr.2 të 2021, të KQZ-së. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim, si dhe listën e vëzhguesve, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Atëherë, vendos:

*Zbardhi materialin audio
Silvi Sino*



***Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021***

1. Të miratojë kërkesën e Community Reporters për akreditimin e 8 vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvend, të datës 25 prill 2021, sipas listës të përcaktuar në lidhjen “1” bashkëlidhur këtij vendimi;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.

Vendimi nr. 175

***Zbardhi materialin audio
Silvi Sino***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

23.03.2021

Ora 15:23

*Projektvendimi “Për miratimin e gazetarëve të Televizionit A2 CNN, për
vëzhgimin e zgjedhjeve për kuvend të datës 25 prill 2021”;*

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Ilirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, V.Ballgjini

• **Parti Politike: LSI, PDIU, PSD,**

• **Koalicione: ABEOK, ADR**


Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Televizioni “A2 CNN” ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 65 (gjashtëdhjetë e pesë) gazetarëve dhe operatorëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se është i plotë, në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor nenin 4 të Udhëzimit nr.2 të vitit 2021. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën e gazetarëve që do të akreditohen.

Z. I. Celibashi: Miratohet dhe kërkesa e Televizioni “A2 CNN”, për akreditimin e 65 (gjashtëdhjetë e pesë) gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për kuvend të datës 25 prill 2021, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr.176

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

23.03.2021

Ora 15:24

Projektvendimi “Për miratimin e gazetarëve të TV Klan News për vëzhgimin e zgjedhjeve për kuvend të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve **Z.Illirjan Celibashi**

2.Stafi KQZ: **Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, V.Ballgjini**

• **Parti Politike:** **LSI, PDIU, PSD,**

• **Koalicione:** **ABEOK, ADR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Televizioni “Klan News” ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 31 (tridhjetë e një) gazetarëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Televizioni “Klan News” është një televizion informativ dhe siguron mbulimin e lajmeve nga vendi, rajoni dhe bota. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor, nenin 4 të Udhëzimit nr.2 të vitit 2021. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën e përfaqësuesve gazetarë.

Z. I. Celibashi: Atëherë miratohet edhe kërkesa e Televizioni “Klan News” për akreditimin e 31 (tridhjetë e një) gazetarëve për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për kuvend të datës 25 prill 2021, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1

*Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI*

1



***Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021***

bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr 177

***Zbardhi materialin audio
Valbona DUSHI***



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

23.03.2021

Ora 15:25

Projektvendimi “Për miratimin e gazetarëve të Televizionit Ora News, për
vëzhgimin e zgjedhjeve për kuvend të datës 25 prill 2021”.

PJESËMARRJA :

• **KQZ**

1.Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve Z.Illirjan Celibashi

2.Stafi KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, V.Ballgini

• **Parti Politike:**

LSI, PDIU, PSD,

Koalicione:

ABEOK, ADR

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

Z. Y. Merkaj: Televizioni “Ora News” ka paraqitur pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për akreditimin e 108 (njëqind e tetë) gazetarëve dhe operatorëve si dhe zonat e vëzhgimit të tyre. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, konstatohet se është në përputhje me nenin 6 të Kodit Zgjedhor dhe Udhëzimin nr.2 të vitit 2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën e gazetarëve dhe operatorëve, faleminderit.

Z. I. Celibashi: Atëherë miratohet edhe lista e vëzhguesve të Televizionit “Ora News”, sipas listës së përcaktuar në lidhjen 1 bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Vendimi nr.178

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

23.03.2021
Ora 15:26

Projektvendim “Për lirim dhe emërim të anëtarëve të KZAZ-së nr. 01, KZAZ-së nr. 07, KZAZ-së nr. 08, Qarku Shkodër, KZAZ-së nr. 10, Qarku Kukës, KZAZ-së nr. 12, KZAZ-së nr. 15, Qarku Lezhë, KZAZ-së nr. 27, KZAZ-së nr. 28, KZAZ-së nr. 32, KZAZ-së nr. 36, KZAZ-së nr. 37, Qarku Tiranë, KZAZ-së nr. 76, Qarku Gjirokastër”.

PJESËMARRJA:


- **KQZ :**
- 1. **Z.Illirjan Celibashi Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- 2. **Stafi i KQZ: Y.Merkaj, M.Koja, E.Allushi, V.Ballgjini**
- **PARTI POLITIKE: PDIU, LSI, PSD**
- **KOALICIONE: ABEOK, ADR**

Z. I. Celibashi: Vazhdojmë me pikën tjetër.

Z. Y. Merkaj: Bazuar nenit 32 paragrafi “2”, shkronja “d” e Kodit Zgjedhor, Partia Demokratike ka paraqitur kërkesë për lirim dhe emërimin e anëtarëve të KZAZ-së nr.8 Qarku Shkodër, të KZAZ-së nr.12 Qarku Lezhë dhe të KZAZ-së nr.36, Qarku Tiranë. Partia Socialiste ka paraqitur kërkesën për lirim dhe emërimin e anëtarit të KZAZ-së nr.7, Qarku Shkodër, të KZAZ-së nr.8, Qarku Shkodër, KZAZ-së nr.10, Qarku Lezhë, KZAZ-së nr.15 Qarku Lezhë, KZAZ-së nr.27 Qarku Tiranë, KZAZ-ja nr.28 dhe KZAZ 37 Qarku Tiranë. Partia Lëvizja Socialiste për Integrim ka paraqitur kërkesën për lirim dhe emërimin e anëtarit të KZAZ-së nr.1, Qarku Shkodër dhe të KZAZ-së nr.32 Qarku Tiranë. Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se është në përputhje me nenin 30, 31 dhe

1

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve
Dt.23.03.2021*

32 të Kodit Zgjedhor. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe listën e anëtarëve të KZAZ-së që lirojnë dhe emërojnë, faleminderit.

Z.I.Celibashi: Miratohet dhe ky projektakt sipas përmbajtjes së tij.

Znj.E.Bushati, përfaqësuese e LN-së: Një pyetje të thjeshtë sapo pashë në media që KAS ka pranuar ankimin e një subjekti zgjedhor për listën e deputetëve. Besoj se me logjikë, do të zbatohet për të gjithë apo tashmë vetëm për subjektin ankimues?

Z.I.Celibashi: Nuk e dimë se çfarë ka urdhëruar KAS-i, ta shikojmë se çka arsyetuar dhe urdhëruar, faleminderit.

Mbledhja mbyllet.

Vendimi nr.179

*Zbardhi materialin audio
Valbona Dushi*

